



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E**  
**TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 982/1 prot.

Tiranë, më 03.05.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektligjin “Për Policinë e Shtetit”

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 3423/5 prot., datë 09.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 982 prot., datë 11.04.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për Policinë e Shtetit” si dhe relacionin shoqërues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektligjit “Për Policinë e Shtetit”, konstatojmë se në tërësi reflektohen parimet dhe rregullat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkohë nëse i referohemi Relacionit shoqërues të projektligjit vërejmë që ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian (BE), megjithatë reflekton praktikat më të mira të këtyre vendeve si dhe adreson rekomandimet e BE-së në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh që legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale është në fazë përafrimi me *acquis communautaire*, dhe konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) 679/2016 dhe Direktivën 2016/680 të BE-së “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla” (në vijim, “Direktiva e Policisë”), i cili pritet të miratohet së shpejti, Zyra e Komisionerit vlerëson

se hartimi i legjislacionit në dy fushat reciproke, në harmoni me njëri-tjetrin, mbetet i rëndësishëm dhe përbën një zhvillim konkret në procesin e integritit të vendit.

Sa më sipër, me qëllim që ky projektligj të jetë në të njëjtën linjë me zhvillimet e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, propozojmë të reflektohen disa ndryshime dhe të mbahen në konsideratë elementët, si vijon:

**Germa f) e pikës 1, e nenit 9 të projektligjit** sugjerojmë që togfjalëshi “...siguron dhe trajton” të riformulohet pasi nuk del qartë kuptimi i paragrafit të parashikuar.

**Pika 9, e nenit 3 të projektligjit** sugjerojmë të riformulohet me këtë përmbajtje:

*“Përpunimi i të dhënave personale nga organet e policisë me qëllim ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike, përshin çdo operacion apo grup operacionesh që kryhen me të dhënat personale ose grupet e të dhënave personale, me mjete automatike ose jo, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi”.*

Gjithashtu, duke qenë se në projektligj janë të përmendura nocionet e mëposhtme, sugjerojmë që **në nenin 9 të tij**, të shtohen dhe dy pika me këtë përmbajtje:

*“Të dhëna personale” ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në legjislacionin specifik për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

*“Transferimi ndërkombëtar” i të dhënave personale ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në legjislacionin specifik për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

**Në pikën 6, të nenit 20, të projektligjit**, në fjalinë e parë pas togfjalëshit “...njofton menjëherë” të shtohet togfjalëshi “...me mjete të sigurta të autorizuar komunikimi”.

**Në nenin 22, të projektligjit**, vërejmë se përdoren termat “Shoqërimi, arrestimi dhe ndalimi” dhe ndërkohë nuk është përfshirë termi “ndalim i përkohshëm” parashikuar në nenin 20 të projektligjit. Në këtë drejtim, vlerësojmë të nevojshme që të saktësohet ndarja e këtyre termave tek përkufizimet dhe në tërësi në tekstin e projektligjit.

**Në pikën 3, të nenit 24, të projektligjit**, në fund të fjalisë të shtohet togfjalëshi “dhe sipas rregullave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

**Në lidhje me pikën iv), të germës c) të nenin 37 të projektligjit**, vërejmë kategori të shtuara të të dhënave sensitive, të cilat do ti merren personave të arrestuar apo të ndaluar. Gjithashtu, në pikën 2 të këtij neni parashikohet se, këto të dhëna mund të merren edhe kundër vullnetit të tyre.

Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit sjell në vëmendjen se, referuar nenit 7, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (*në vijim, “Ligji”*), të dhënat sensitive gëzojnë një mbrojtje më të gjerë. Në këtë kuadër duhet mbajtur parasysh parimi i mjaftueshmërisë së të dhënave dhe përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë proporcional në raport me qëllimin e mbledhjes, me kusht, që të zbatohen masa të përshatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjekteve të të dhënave.

Për sa më lart, në respektim të këtij parimi, sugjerojmë që të vendoset një kategorizim shterues i veprave të dyshuara penale për të cilat mund të lejohet përpunimi i kësaj kategorie të të dhënave sensitive.

***Në pikën 4, të nenit 37, të projektligjit*** është parashikuar “*Për të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia krijon bankën qendrore për regjistrimin e të dhënave të mbledhura*” .

Ndërkohë në ***nenin 3, të ligjit nr. 8792, datë 10.5.2001*** “Për krijimin e qendrës së përpunimit të të dhënave” është parashikuar se “*Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit krijohet Qendra e Përpunimit të të Dhënave e cila, duke përdorur teknikat informatike, bën mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave dhe të informacioneve për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e krimeve....Banka e të dhënave është një dhe e përbashkët për të gjitha strukturat e policisë”*”.

Për sa më lart, vlerësohet i rëndësishëm një sqarim se cili është raporti i bankave të parashikuara në secilin prej këtyre dy legjislacioneve specifike.

***Në pikën 5, të nenit 37, të projektligjit***, sugjerojmë që togfjalëshi “*me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

***Në pikën 1, të nenit 39, të projektligjit***, pas fjalës “*dispozitat...*” të shtohet fjala “*e legjislacionit*”.

***Në pikën 3, të nenit 39, të projektligjit***, parashikohet se “*Policia mbledh të dhëna nga burime të hapura publike, përfshirë ato mediatike, regjistrimet e kamerave në mjedise publike, si dhe baza të dhënash të krijuara nga agjenci shtetërore në të cilat i është garantuar aksesimi me ligj ose me marrëveshje për njohjen dhe përdorimin e të dhënave.*”

Në lidhje me aksesin në të dhënat personale të administruara në bazat e të dhënave, gjejmë rastin të rritshëm qëndrimin tonë të vazhdueshëm si autoritet mbikëqyrës, se ky veprim/përpunim, në mënyrë që të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë së përpunimit, të përcaktuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, duhet të jetë i autorizuar me ligj.

Sa më sipër, sugjerojmë që aksesit në bazat e të dhënave të njëjet vetëm me ligj dhe është ligji që mund të delegojë në instrumenta të tjerë si aktet nënligjore apo marrëveshjet e përbashkëta përcaktimin e elementëve të përpunimit sikurse janë mënyra, forma dhe niveli i aksesit. Megjithatë duhet pasur parasysh se pavarësisht autorizimit me ligj të aksesit, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht dhe gjithnjë një akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në të dhënat e kërkuara.

Për këtë arsye, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me parimin e ligjshmërisë së përpunimit, të përcaktuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe, rrjedhimisht, të parandalohen cenime eventuale të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave si rezultat i përpunimeve të mundshme ekseseve (në tejkalim të qëllimit), është e domosdoshme që të merren masa konkrete (i) për sigurimin e gjurmueshmërisë së aksesit në të dhëna, si dhe (ii) përcaktimin e niveleve të aksesit në përputhje me dispozitat ligjore që e autorizojnë atë – në harmoni të plotë me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së kontrolluesit (autoritetit/institucionit) që i është akorduar ky akses (që në rastin konkret është Policia e Shtetit).

Ndërkohë, edhe për **pikën 1, të nenit 40, të projektligjit**, vlen i njëjti koment i sipërpërmendur.

**Në pikën 3 dhe 4, të nenit 40, të projektligjit**, në mënyrë që të unifikohen terminologjia e përdorur në këtë projektligj, sugjerojmë që togfjalëshi “përdorimin e të dhënave” të zëvendësohet me togfjalëshin “përpunimin e të dhënave”.

**Pika 1, e nenit 42, të projektligjit**, sugjerojmë të ndryshohet në përputhje me legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë të gjitha format e përpunimit të të dhënave, me këtë përmbajtje:

*“1. Përpunimi i informacionit policor është procesi i mbledhjes, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi, për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale”.*

Fjalja e fundit e **pikës 2, e nenit 43, të projektligjit**, sugjerojmë të riformulohet si vijon: *“Policia mund transmetojë të dhënat personale tek palët e treta, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Sa i përket **nenit 44 të projektligjit**, me qëllim shmangien e mbivendosjes së dispozitave dhe detyrimeve që burojnë prej tyre si dhe duke qenë se “*Transferimi ndërkombëtar i të dhënave ndërmjet autoriteteve kompetente*” është parashikuar në **Seksionin II, të Kapitullit II të Projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”** i cili përaftron Direktivën e Policisë,

sugjerojmë që neni 44 i projektligjit “Për Policinë së Shtetit” të jetë dispozitë referuese në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vijim, **përmbajtja e nenit 44 të projektligjit** të ndryshohet me këtë përmbajtje:

### **Transferimi ndërkombëtar i të dhënave**

*“Për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt vendeve që kanë apo nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, zbatohen dispozitat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

**Në pikën 1, të nenit 90, të projektligjit**, të shtohet një germë me këtë përmbajtje: *“është i detyruar që përpunimin e të dhënave personale gjatë veprimtarisë së tij ta kryej me mjete të sigurta dhe të autorizuara”.*

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj do të konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**